STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 maj 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE SHTETI DO TE MBULOJE KOSTOT E ZHVENDOSJES SE LINJAVE TE KORRENTIT PER SHTEPITE E PREKURA NGA SENDI (SANDY)

NY do të përkushtojë një pjesë të fondeve federale për Sendin (Sandy) për zhvendosjen ose ngritjen e linjave të korrentit në mënyrë që taksapaguesit dhe paguesit e tarifave të mos e mbartin këtë kosto

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Nju Jorku (New York) do të përkushtojë një pjesë të fondeve federale për Sendin (Sandy) për të mbuluar koston e ngritjes ose zhvendosjes së linjave të korrentit për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) shtëpitë e të cilëve janë ende në ndërtim dhe duhet të ngrihen për të qënë në përputhje me kodet. Duke mbuluar këtë kosto, paguesit e tarifave dhe pronarët e shtëpive nuk do të mbartin këtë kosto. Zyra e Guvernatorit, së bashku me Autoritetin e Korrentit të Long Ajlënd (Long Island Power Authority) (LIPA), kanë hartuar një plan për të mbuluar kostot e ngritjes ose zhvendosjes së linjave të tij të korrentit pa kosto për pronarët e pronave dhe për të bashkërenduar me departamentin e ndërtesave bashkiake në zonat e prekura për të siguruar se lejet e ndërtimit nuk do të vonohen.

"Dëshirojmë të sigurohemi se banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që janë duke u rimëkëmbur nga uragani Sendi (Sandy) nuk përballen me barra ose kosto financiare shtesë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Shteti është duke paguar faturën për këto rregullime të linjave tona të korrentit për të ndihmuar që komunitetet tona të rimëkëmben dhe për t'a bërë shtetin tonë më të sigurtë dhe më të përgatitur për katastrofa natyrore të ardhshme."

Riçard Kaufman (Richard Kauffman), Kryetar për Energjinë dhe Financën, i dërgoi një letër Skot J. Mandel (Scott J. Mandel), Presidenti i Këshillit të Qytetit të Long Biç(Long Beach), duke e informuar atë për planet e LIPA-s dhe sesi shteti synon të mbulojë koston. Shumë shtëpi anembanë zonës së përmbytjes, përfshirë shtëpi në Long Biç (Long Beach), Rokëuejs (Rockaways), Brizi Point (Breezy Point), Ajlënd Park (Island Park), Osheansajd (Oceanside) dhe Fajër Ajlënd (Fire Island) u dëmtuan rëndë dhe do të duhet të rindërtohen e ngrihen për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të kodit. Shteti i Nju Jorkut (New York State) është i angazhuar plotësisht për të siguruar ndihmën e nevojshme për të ndihmuar që pronarët e shtëpive të rindërtojnë në një mënyrë të lehtësuar, duke siguruar gjithashtu se paguesve të tarifave në Long Ajlënd (Long Island) nuk u jepen faturat për kostot që kanë lidhje.

Letra është më poshtë:

10 maj 2013

I dashur President i Këshillit Mandel:

Në emër të Guvernatorit Kuomo (Cuomo) ju shkruaj duke iu përgjigjur letrës tuaj të 9 majit ndaj Autoritetit të Korrentit të Long Ajlënd (Long Island Power Authority) (LIPA). Letra juaj identifikoi dy shqetësime të rëndësishme që janë duke prekur banorët që ende përpiqen të rimëkëmben nga super stuhia Sendi (Sandy): (1) kush do të mbartë koston e ngritjes dhe zhvendosjes së linjave të korrentit për shtëpitë e rindërtuara që duhet të ngrihen dhe (2) si do të bashkërendojë LIMA punën e saj për linjat e korrentit me departamentet e ndërtesave vendore për t'u siguruar se lejet e ndërtimit mund të përpunohen për pronarët e prekur të shtëpive në kohë.

Jam i gëzuar të njoftoj se Shteti i Nju Jorkut (State of New York) do të përkushtojë një pjesë të fondit federal të shtetit për Sendin (Sandy) për të mbuluar kostot e ndërmarrjes për ngritjen e linjave të korrentit në këto situata, në mënyrë që pronarët e shtëpive dhe paguesit e tarifave të izolohen nga kosto të tilla. LIPA, në bashkërendim me zyrën tonë, ka hartuar një plan për të mbuluar kostot e ndërmarrjes për ngritjen ose zhvendosjen e linjave të saj të korrentit krejtësisht pa kosto për pronarët e shtëpive dhe për të bashkërenduar me departamentin e ndërtesave tuaja (dhe departamentet e ndërtesave të tjera të prekura anembanë Long Ajlënd (Long Island)) për t'u siguruar se lejet e ndërtimit nuk do të vonohen.

E kuptojmë se shtëpitë anembanë zonës së përmbytjes u dëmtuan rëndë e do të duhet të rindërtohen dhe shumë prej këtyre shtëpive do të duhet të ngrihen për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të kodit. Jemi të angazhuar plotësisht për të siguruar ndihmën e nevojshme për të ndihmuar pronarët e shtëpive që të rindërtojnë në një mënyrë të lehtësuar, duke siguruar gjithashtu se paguesit e tarifave në Long Ajlënd (Long Island) nuk paguajnë faturat për kostot që kanë lidhje me këtë.
I kam dërguar këtë letër Xhon Mekmahon (John McMahon), i cili do të kontaktojë zyrën tuaj sot për të planifikuar një takim për të diskutuar planin e LIPA-s.

Ju falënderoj për letrën dhe angazhimin tuaj për të ndihmuar që banorët të rindërtojnë me siguri dhe shpejtësi.

Sinqerisht,

Riçard Kaufman (Richard Kauffman)
Kryetar i Energjisë dhe Financës, Zyra e Guvernatorit

Kopje:

Albanian

Marianela Xhordën (Marianela Jordan), Përfaqësuesja Rajonale e Long Ajlënd (Long Island) për Guvernatorin Kuomo (Cuomo)
Xhon Makmahon (John McMahon), COO LIPA

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418